

FJALA E DEPUTETES HATIXHE KONOMI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, Jemi, pa diskutim, në një nga seancat më thelbësore të vitit, ku po diskutohet buxheti më i madh në historinë e shtetit shqiptar, ai i vitit. Pesa që bart ky buxhet është i një rëndësie të veçantë. Kjo për vetë misionin që ka në përmbushjen e programit ambicioz të Partisë Socialiste, duke menaxhuar ecjen në rrugën e vështirë të rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy sfidave të mëdha, siç ishte tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe pandemia COVID 19. Të nderuar kolegë të opozitës, Kërkoj që, të paktën, në seanca si kjo e sotmja të mos bëjmë retorika politike boshe, por të mendojmë për vendin dhe për qytetarët, sepse këtu bëhet fjalë për një përgjegjësi shumë më të madhe sesa një përfaqësim logosh politike, këtu bëhet fjalë për përfaqësim të qytetarëve dhe interesave të tyre e të vendit dhe interesat e tyre sa i përket buxhetit janë të njëjta. Pikërisht ky buxhet, në mënyrë të pakontestueshme, çdo qindarkë të tij e ka të adresuar në favor të shtimit të sasisë dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe mbrojtjes sociale për ata që kanë më shumë nevojë, digitalizimit dhe investimeve kyçe në infrastrukturë. Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 programohen në nivelin 34,1% të prodhimit të brendshëm bruto, përmes të cilave vijnë të gjitha investimet e nisura në sektorët e shëndetësisë, mbrojtjes sociale, arsimit, infrastrukturës, rindërtimit, si dhe bujqësisë. Ndërkohë, dua të theksoj se këta sektorë janë në nivele buxhetimi si kurrë më parë. Ky është buxheti i njerëzve, ky është buxheti i qytetarëve.

Për të mos përsëritur detajet, që tashmë janë trajtuar gjerësisht dhe me hollësi nga kolegët parafolës të maxhorancës, më lejoni që shkurtimisht të risjell në vëmendje disa prej pikave më të rëndësishme të buxhetit: Rriten pagat për punonjësit e sektorit të shëndetësisë, arsimit, të efektivëve të Forcave të Armatosura, si dhe financohen pagesat e papunësisë së naftëtarëve. Parashikohet indeksimi i pensioneve, prej 2,6 miliardë lekësh, rritet fondi i mbështetjes për shtresat në nevojë, pra ndihma ekonomike rritet me 10%, trefishohet ndihma për gratë e trafikuar e fëmijët e mitur, si dhe dyfishohet ndihma për nënat me shumë fëmijë. Parashikohen shpenzimet për pagesën e papunësisë, me 900 milionë lekë, pagesa e aftësisë së kufizuar me 23,5 miliardë lekë dhe për ish -të përndjekurit një fond prej 1 miliard lekësh. Vijon skema e librave shkollorë falas për nxënësit nga shtresat në nevojë, e cila zgjerohet deri në shkollë të mesme; sigurohet transporti për nxënësit dhe mësuesit që banojnë larg nga shkolla, si dhe 700 milionë lekë të alokuara për projektet twining për universitetet. Vijnë fokus në shëndetësi me financimin e vaksinës COVID 19, vijon skema e rimbursimit të barnave dhe bonusit të bebes, si dhe fondi prej 750 milionë lekësh për spitalin rajonal të Fierit. Përmendim, gjithashtu, fondin e rindërtimit, i cili shkon në 20 miliardë lekë dhe transfertën kapitale të fondit të shpronësimeve në 1,8 miliardë lekë.

Vijnë Investimet e rëndësishme në infrastrukturën rrugore. Këtu përmendim Rrugën e Arbrit, unazën e jashtme të Tiranës dhe i saponisuri projekt madhor i tunelit të Llogarasë, çelja e punimeve të të cilit na bëri të gjithëve entuziastë. Në buxhet parashikohen linjat e reja hekurudhore Tiranë-Durrës, Tiranë-Rinas, investimet për portet e Durrësit dhe Vlorës, si dhe aeroportet e Vlorës dhe të Sarandës. Të dashur qytetarë, Po kalojmë një sprovë të vështirë ekonomike e sociale dhe, pavarësisht kësaj, qeveria

ka dëshmuar një vullnet të pashoq për të menaxhuar emergjencat e imponuara dhe, në të njëjtën kohë, për të çuar para vizionin për zhvillimin e vendit. Partia Socialiste ka provuar me kohë së është një forcë e orientuar nga puna dhe tani provoi se asgjë nuk e ndal për të arritur objektivat e saj në interes të qytetarëve të vendit. Në këtë pikë, dua të ndalem dhe ta ilustruj këtë fakt me situatën në qarkun e Beratit dhe kryesisht bashkinë, të cilën unë përfaqësoj. Përpara se Edi Rama dhe Partia Socialiste të merrnin drejtimin e këtij vendi, Berati ishte i izoluar, pasi rruga kryesore, që e lidhte me pjesën tjetër të vendit, ishte totalisht e amortizuar duke larguar për vite më radhë vizitorët dhe turistët e vendit, por sot gjithçka është ndryshe. Tashmë, Berati ka nisur rrugën e pakthyeshme të transformimit infrastrukturor për rikthimin e dinjitetit të tij dhe për ta ngritur në pedestalin e merituar të një qyteti, i cili nuk është vetëm pasuri kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Turizmi është e ardhmja që po bëhet përditë realiteti i qarkut tonë, ku po zhvillohen, si asnjëherë më parë hoteleria, bujqësia, argotizmi dhe agropërpunimi.

Për ta kthyer në terma konkretë: vetëm në dy vjetët e fundit, në kulmin e situatave të emergjencave, qeveria, në bashkëpunim me donatorët dhe bashkinë e Beratit, kanë implementuar investime strategjike me vlerë më të lartë se 20 vjetët e fundit të bëra bashkë. Ka përfunduar rruga e Kalasë, një projekt prej gati 300 milionë lekësh, duke i dhënë përfundimisht zgjidhje një problemi të bartur prej dekadash. Kjo rrugë krijon kushte optimale për operimin e mjeteve të zonës dhe turistëve për të vizituar kalanë; eliminon trafikun në qendrën historike, në rrugën Mihal Komnena dhe rivitalizon të gjithë zonën përreth. Gjithashtu, ka përfunduar bajpasi i vogël i qytetit, projekt prej 110,6 milionë lekësh. Kjo rrugë shtrihet në një zonë me aktivitet të lartë në fushën e turizmit dhe, njëkohësisht, realizon lidhjen ndërmjet zonave të banuara, duke rritur cilësinë e jetesës së banorëve të dy njësive administrative Velabisht dhe Sinjë, si dhe nxit mundësinë për investime në fushën e turizmit, bujqësisë dhe blegtorisë. Ka nisur projekti i restaurimit të peizazhit historik urban të lagjes Goricë, me vlerë totale 466,6 milionë lekë, projekt që përfshin, gjithashtu, edhe rehabilitimin e shtegut të kalasë së Goricës, si dhe ndërtimin e një parkimi pranë urës së vjetër të Goricës. Projekti rehabiliton të gjithë lagjen Goricë, duke afruar imazhin me atë çfarë kjo lagje përfaqëson. Gjithashtu, në mënyrë të drejtpërdrejtë përmirësohen kushtet e jetesës së banorëve dhe nxitet rritja ekonomike bazuar në zhvillimin e turizmit lokal në zonat urbane. Rikualifikimi urban i unazës së re të Beratit, ose siç e njohin ndryshe qytetarët bajpasi i madh, më një vlerë prej gati 800 milionë lekësh, aksi i projektuar, do të funksionojë si unazë e qytetit me një impakt tepër të madh si nga pikëpamja funksionale, ashtu edhe nga pikëpamja turistike. Ky aks i jep frymë zhvillimit të zonës dhe ul trafikun nga automjetet e tonazheve të mëdha, që nuk i kanë hije Beratit dhe qendrës së tij historike. Projekti i ndërtimit të godinës së parkimit dhe hapësirave mbështetëse, i cili po realizohet në sheshin qendror Teodor Muzaka, mundëson ndërtimin e parkimit më një kapacitet 200 vendesh nëntokë dhe krijimin e një sheshi multifunksional në sipërfaqe të tij. Ndërkohë po zgjidhet, njëherë e mirë, problemi i furnizimit më ujë të pijshëm në zonat urbane dhe rurale të bashkisë, si: në rajonin nr.1, lagjen Goricë, ujësjellësit e fshatrave Lapardha e Orizaj në njësinë Otllak, si dhe ujësjellësit e fshatrave Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik dhe Duhanas të njësisë administrative Velabisht. Projekti i menaxhimit të mbetjeve të ngurta e rendit qarkun e Beratit si një ndër qarqet pararojë në iniciativa të tilla me impakt të madh mjedisor. Rehabilitimi i stacionit të zjarrfikëses e kthen në një model për të gjithë vendin dhe rrit ndjeshëm sigurinë e mbrojtjeve nga zjarri, i cili mund të këtë pasoja të pakthyeshme për një qytet me specifikat e Beratit.

Kompleksi i ri i shërbimeve të transportit rrugor do të garantojë një cilësi krejt të re shërbimi për drejtuesit e automjeteve për të gjithë qarkun. Ndërtimi i qendrës multifunksionale rinore ofron një hapësirë bashkëkohore krijuese për art, për sport, për zhvillimin e aftësive profesionale, nxitjen e inovacionit, funksionimin e inkubatorit të biznesit për komunitetin e të rinjve, duke rritur përfshirjen e tyre në jetën aktive të qytetit dhe krijimin e mundësive të punësimit nëpërmjet rritjes së

kapaciteteve e të tjera. Ka nisur vëmendja ndaj zonave rurale me projektin e rehabilitimit të rrugës kryesore të fshatit Drobonik. Ky është një model angazhimi, i cili duhet të shtohet në vijim, pasi infrastruktura rurale ka nevojë për vëmendje të shtuar në këtë mandat të tretë. Turizmi, bujqësia dhe agrobiznesi janë drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik të Beratit dhe investimi në infrastrukturën rurale do t'i jepte një hov akoma më të madh zhvillimit të tyre. Bujqësia është një potencial shumë i rëndësishëm për Beratin. Programi i qeverisë për mbështetjen e fermerëve nëpërmjet AZHBR-së që nga viti 2013 ka qenë një ndihmë e jashtëzakonshme për fermerët dhe ekonomitë e vogla në fshatrat e Beratit. Roshniku dhe, së fundi, Qafë-Dardha, me përfshirjen e tyre në projektin e "100 fshatrave", janë shembulli më i mirë sesi njësitë tona administrative janë një potencial i jashtëzakonshëm i argotizmit dhe i turizmit të aventurës.

Ndaj, thirrja ime, si deputete e zonës, do të ishte për vëmendje të shtuar për këto zona, përkthyer në investime konkrete. Unë mendoj së mënyra e duhur për të rritur e fuqizuar më shumë ekonominë lokale është të bashkojmë energjinë e njerëzve të zakonshëm me projekte madhore që po zbatohen dhe që do të vijojnë të shtohen nga qeveria Rama gjatë mandatit të tretë qeverisës për kthimin e Beratit në një destinacion të vërtetë të turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar. Që t'i bëjmë të mundura të gjitha këto, të dashur kolegë, ju ftoj ta votojmë dhe ta mbështesim projektbuxhetin e vitit 2022! Faleminderit!